



Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

LAJMËRIM PARAPRAK

për publikim të Thirrjes publike numër 02/2019 për parashtrim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve në lidhje me masën 3 "Investime në mjetet themelore për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut" në fushën e politikave për bujqësi dhe zhvillimin rural të Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi 2014-2020)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik se në pjesën e dytë të muajit dhjetor 2019 planifikohet të shpallet Thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare në lidhje me masën 3 "Investime në mjetet themelore për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut" nga fusha e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural të Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi për periudhën 2014-2020).

Qëllimi i IPARD Programit 2014-2020 është përmes masave përkatëse për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektorit bujqësor-ushqimor, përmes harmonizimit të tyre me standardet e Bashkimit Evropian dhe arritjes së ambientit të qëndrueshëm jetësor dhe zhvillim socio-ekonomik në mjediset rurale përmes nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjes së mundësive për punësim.

Mjetet financiare në lidhje me masën 3 "Investime në mjetet themelore për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkut" nga IPARD Programi 2014-2020 në lidhje me realizimin e kësaj Thirrje publike nga dhjetori i vitit 2019 dedikohen për mbështetjen financiare në llojet e investimeve në vijim:

➤ Investime në mjetet themelore për përpunimin dhe marketingun e prodhimeve bujqësore dhe të peshkut:

1. Qumësht dhe prodhime të qumështit
2. Mish dhe prodhime të mishit (përfshirë vezë dhe shpendë)
3. Pemë dhe perime (përfshirë patatet, kërpudhat dhe kulturat bishtajore)
4. Drithëra, produkte që bluhën dhe produkte nga niseshteja
5. Prodhime vegjetale dhe vajra dhe yndyra të kafshëve
6. Shirë, verë dhe uthull
7. Prodhim të energjisë përmes lëvizjeve për përpunimin e produkteve bimore dhe të kafshëve nga biomasa primare dhe sekondare, me përjashtim të biomasës nga produktet e peshkut.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020 udhëzojnë arritjen e kontratës paraprake të shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në pajtim me kushtet e kontraktuar paraprakisht. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë së Veriut për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Unioni Evropian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e përkrahjes financiare nga IPARD Programi 2014-2020 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian.

Shpallja do të zgjasë **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në shtypin ditor.

VËREJTJE: Kërkesa për mbështetje financiare e cila nuk e përmban dokumentacionin e duhur në momentin e parashtrimit të kërkesës, Agjencia do ta refuzojë si të pakompletuar. Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit në lidhje me masën 3 "Investime në mjetet themelore për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut" nga IPARD Programi 2014-2020 do të azhurmohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike.

Informata më detale në lidhje llojet e investimeve, kriteret për fitimin e përkrahjes financiare, shumat e përkrahjes sipas masave të interesuarit mund t'i marrin në Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Telefoni: 02 3097-460

Faksi: 02 3097-454

e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.pa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Sektori për udhëheqje me IPARD

Telefoni: 02 3134-477 lok: 113, 114 dhe 115

e-mail adresa: info@ipard.gov.mk

www.ipard.gov.mk

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi

Telefoni: 047 228-330

Faksi: 047 228-370

www.agencija.gov.mk çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Informata për përgatitjen dhe dorëzim të kërkesave, si dhe këshillat praktike për aplikim, të interesuarit falas mund t'i marrin në qendrat regionale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi. (Lista e kontakteve të qendrave regionale dhe personave kompetentë është e shpallur në ueb faqen e institucioneve kompetente)



Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të
Bashkimit Evropian 2014-2020

